

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hungari/ Parlamenti i heq imunitetin kryeministrit Péter Magyar dhe dy ish-ministrave të Orbánit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/hungari-parlamenti-i-heq-imunitetin-kryeministrit-pter-magyar-dhe-dy-ish-mi-i589021
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:32:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f7553a402d2079dd2db26bdb53bc5fbf3e999b9b32843a5cbe7953164e8ce486
TEKSTI	989c8feb3fc70ac31830da07c504f81c1549f7c5c902a3668420abaf85b016b8
PAMJA	e25f8c6221fcdcf9471359c6e7a2b5729e76c01df9357644fc0972775696c0a1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4d87642635907c0aa383af6c37e0f58764f3ba36ddbf2e91889d4e0b75d7b8ab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4d87642635907c0aa383af6c37e0f58764f3ba36ddbf2e91889d4e0b75d7b8ab>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie Hungari/ Parlamenti i heq imunitetin kryeministrit Péter Magyar dhe dy ish-ministrave të OrbánitKomandanti i NATO-s: Rusia po rrit presionin mbi qeverite evropiane | fundit

Hungari/ Parlamenti i heq imunitetin kryeministrit Péter Magyar dhe dy ish-ministrave të Orbánit



28 Shtator 2026, 19:30Bota TEMA



Me 139 vota pro, Parlamenti i Hungarisë i hoqi imunitetin kryeministrit Péter Magyar dhe dy ish-ministrave të FIDESZ, partisë së Viktor Orban, Balázs Hankó dhe Miklós Seszták.

Votimi i së hënës erdhi pas hetimeve të veçanta penale ndaj tyre, pasi Prokuroria e Përgjithshme kërkoi javën e kaluar heqjen e imunitetit të tre deputetëve, në mënyrë që të mund të vijonte hetimet.

Hetimi ndaj kryeministrit ka të bëjë me një incident të ndodhur në qershor të vitit 2024, kur Magyar dyshohet se i mori telefonin një personi ndërsa ai po e filmonte në një klub nate në Budapest dhe më pas e hodhi qëllimisht në lumin Danub.

Zyra e prokurorit tha se veprimet e tij përmbushnin kriteret ligjore për vjedhje. Lideri pro-evropian i Hungarisë e kishte kërkuar vetë heqjen e imunitetit të tij duke thënë se merr përgjegjësi për te gjitha veprimet e tij, por i cilesoi akuzat si te motivuara politikisht.

Ndërkohë dy ish ministrat e qeverisë “Orban” akuzohen për nga prokuroria për korrupsion. Hetimi ndaj deputetit të Fidesz-it, Balázs Hankó, ish-Ministër Kulture në qeverinë e Orbánit, i cili dyshohet për keqpërdorim të rreth 53.6 milionë dollarëve nga Fondi Kombëtar Kulturor i Hungarisë.

Prokurorët po hetojnë ish-ministrin e Zhvillimit në kohën e Orbánit, Miklós Seszták, se ka marrë mbi 37 milionë dollarë rryshfet lidhura me blerjen e automjeteve në kompaninë shtetërore të autobusëve të Hungarisë si dhe me projekte shtetërore në fushën e ndërtimit.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Komandanti i NATO-s: Rusia po rrit presionin mbi qeveritë evropiane për të ndalur mbështetjen ndaj Kievit](#)

19:20 Bota

Alarm për bombë në Harvard/ Evakuohet zona pranë Memorial Hall, pezullohen autobusët

18:40 Bota

["A doni të blini armë nga SHBA?" - Trump ia bëri pyetjen Xi Jinping, Departamenti i Shtetit jep sqarimin](#)

18:20 Bota

[Gjermania mbështet Gjykatën Ndërkombëtare Penale pas sanksioneve nga Amerika](#)

17:40 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.